

Tabela për Konsultimin Publik
të Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar”, të ndryshuar

Titulli i projekt-aktit	Afati i paraqitjes në KM	Objekti/Qëllimi	Peridha e konsultimit publik	Mënyra e konsultimit publik	Komente
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar”, të ndryshuar	Katërmujori III i vitit 2019	Qëllimi i propozimit të këtij projektligjit Nr.7643, datë 02.12.1992, “Për Inspektimin Sanitar”, i ndryshuar, është ligji bazë i cili rregullon kontrollin për përmbushjen e kushteve higjieno-sanitare në funksion të shëndetit publik, i cili përfshin shumë fusha dhe faktorë që ndikojnë për ruajtjen e tij si një e mirë publike. Në ligjin aktual përcaktohet Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (këtu e në vijim: struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit) si organi që kontrollon zbatimin e akteve ligjore, nënligjore me objekt inspektimin e ruajtjes së kushteve higjieno-sanitare në veprimtaritë e ndryshme që ushtrojnë personat fizikë, juridikë, publike dhe jopublike. Në kuadër të reformës në bujqësi dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, bazuar në rregulloren e BE 178/2002, 854/2004, 888/2004, i cili rregullon çështjet e higjienës dhe sigurisë së ushqimit, është krijuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (këtu e në vijim: institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit) dhe një sistem i kontrollit formal për ushqimin e njerëzve, kafshëve me qëllim garantimin e një niveli të lartë të	Sipas Parashikimeve të Ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. .	1. Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. http://www.shendetesia.gov.al/al/baza-ligjore/legjislacioni/projekt-akte Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992, “Për inspektimin sanitar” të ndryshuar”, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më datë 22.10.2019. Ne konsultim ishin perfaqesues nga Ministria e	2. Në tyrezen e konsultimit u prezantua projektligji dhe risitë që sjell. Pjesmarresit shprehen dakordesine ne lidhje me sugjerimet e prezantuara ne kete projektligj.

		mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, interesit të konsumatorit. politikë Me miratimin e akteve të lartpërmendura është krijuar mbi vendosje ndërmjet kompetencës për inspektim higjieno-sanitar në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.		Shëndetësisë dhe Mbrojtje Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe pjesmarrjen e përfaqësuesve nga Inspektorati i Lartë Shëndetësor		
		OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i> ➤ Ndarja e qartë e kompetencave ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda vitit 2020 dhe mbrojtja e shëndetit publik nëpërmjet inspektimeve higjieno-sanitare të kryera nga institucionet përgjegjëse. ➤ Ndërmarrja e procedurave administrative përkatëse për kalimin e inspektorëve nga struktura përgjegjëse për				

		inspektimin në fushën e shëndetit te institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda vitit 2020, me qëllim fuqizimin e institucioneve. • Eleminimi i inspektimeve të dyfishta, brenda vitit 2020, në bizneset që operojnë në fushën e prodhimit, ruajtjes, magazinimit , transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, me qëllim lehtësimin e bizneseve nga barra ekonomike dhe sociale.				